

## E DIELA E GJITHE SHENJTOREVE

*Në Mbrëmësoren këndohen gjashtë Thirrtores të Tingëllit  
Tërthor IV, dhe katër të Shenjtorëve:*

## THIRRTORET

## PAS OLIN APOTHEMENI, T.T. II.

O dishepuj të Jesujt, o oratorë t' Ungjillit, organë të Shpirtit Shenjt, plot me bes' e zell edhe plot me hir; në çdo kënt kudo mi dhe, e lëcittë Zotin Krisht, edhe dogmat e Sinodeve, posht' e lart i mbualhtë, edhe i vaddittë me gjak dhe lot, dhe vuat si Mësonjësi, gjer në kryqësim edhe gjer në varr; dhe kështu fituat, kurorë si Shenjtorë me lavdi, pra nërmjetoni dhe falnani, ndjesën e mëkatave.

Nga zelli përvëlohëshit, nga dashuria qjellore, zjarrin s' e përfillt' aspak, digjëshit si prushi dhe sqyfuli; o Dëshmorë plot me laft, si në furr' i bëtë shkrimp, gjithë drizat drut' e shtrëmbëra, ujqve heretikëve, gojë të ua mbylltë për gjithënjë; dhe therësit mundonjësit, mun' në gjakun tuaj përmbytëshin; dhe kështu fituat, kurorë si Shenjtorë me lavdi, pra nërmjetoni dhe falnani ndjesën e mëkatave.

Lëftonit kundër bishave, edhe me shpata ju çponin, jua prinin duartë, jua çkulnin thonjtë mundonjësit; po ju nuk u-trëmpt' aspak, as u-tunt' asfare, nuk u-dhatë as kur digjëshit, kur sakatosëshit, dhe kur copëtohëshit gjithësej; duronit dhe s' ankohëshit, prisnit vetëm gjyqin e Zotit Krisht; dhe kështu fituat, kurorë si Shenjtorë me lavdi, pra nërmjetoni dhe falnani, ndjesën e mëkatave.

Anëmbanë botëve, u-shenjtëruan me besë, Apostuj dhe Priftërinj, Ashkëtinj Dëshmorë dhe Gra me nam, eni pra kremtojin, dhe me hymne psallini, me trumbeta brohoritini, se na e suallnë, qjellin tatëpjetë këtu mi dhe, për ne duruan trimërisht, na përndanë hirin e Zotit Krisht; dhe kështu fituat, kurorë si Shenjtorë me lavdi, pra nërmjetoni dhe falnani, ndjesën e mëkatave.

## LAVDI, T.T. II

O Dëshmorë të Shenjtë, o kollona të Kishës, o lëcittë të Ungjillit, ju i mbaruat me vepra, fjalët e Shpëtimtarit; ju i mbylltë portat e Ferrit, që ishin hapur kundër Perëndisë; me gjakun tuaj i përmbyttë, gënjeshtat e të pabesëve; me mundimet tuaja i çudittë Engjëjtë; me vdekjen tuaj i ngjalltë besnikët; tani qëndroni me kurorë, përpara fronit të Perëndisë, dhe nërmjetoni pa pushuar për shpëtimin e shpirtëve tona.

## TANI, T.T. IV.

O Mbreti Krisht që rri në qjell, nga njeridashja jote, u-duke mi dhenë, dhe me njerin' u-shoqërove; se prej Zonjës Shën Mari, more trupin si njeri, edhe linde prej asaj, me një shtim çuditërisht, një person' e Bir, me dy natyra, po një nga e qënura; pra të plottë si një Perëndi, të plottë dhe si njeri, të lëcitim gjithënjë, dhe të rrëfejmi' o Jesu Shpëtimtar dhe Zot; pran' ati nërmjeto o Hyjlindëse, që të shpëtojme prej rezikeve.

*Pasvargjet e Tingëllit, pastaj Përlëshoret e Tingëllit, edhe e Gjithë Shenjtorëve. Në Shërbesën e Mëngjezit thuhet Ndënjësoret, Dëgjimi, dhe Shkallesat e Tingëllit Tërthor IV.*

## SHKURTORJA E SHENJTOREVE, T.T. IV.

## OS APARKHAS TIS FISEOS

Posi kulloshtër dhe kurban, për Perëndinë krijetar, bota e tërë të blaton o Zot, ushtërit' e Dëshmorëve. Pra me lutjet e tyre, në paqe të thellë Kishën ruaj-e, me anën e Shën Marisë, o Perëndi mëshirëplot.

## SHTEPIA

Dëshmorët, që kanë vuajtur mi dhenë, dhe gëzohen në qjellin, janë mbledhur sot në Kishën, e cila i thërret Jesujt: Ti ruaj-më me anën e Shën Marisë, o Perëndi mëshirëplot.

## SINAKSARI

Gjithë sot, të Dielën e Parë pas Rushajeve, kremtojmë të Gjithë Shenjtorët e botës së tërë në Asi, në Libi, dhe në Europë, në Veri dhe në Jugë.

Me nërmjetimet e Shën Marisë dhe të Gjithë Shenjtorëve, o Krisht o Perëndi, mëshirona dhe shpëtona, si i mirë dhe njeridashës. Amin.

*Zbritësore: "Ja gojën e çel tani."*

## UNJILLI I MENGJEZIT PAS MATTHEUT

Më atë kohë, të njëmbëdhjetë dishepujtë vajtin në Galile, në malin ku i kishte porrositur Jesuj. Dhe kur e panë, iu-falnë, po ca dyshuan. Dhe u-afua Jesuj, dhe u foli dyke thënë: "Më është dhënë e tërë fuqia mi qjellin edhe mi dhenë. Ecëni, pra, dhe nxënësojini gjithë kombet, dyke i pagëzuar më emrin e Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, edhe dyke i mësuar t'i ruajnë

të gjitha ato, që ju porrosita. Dhe ja, unë do të jem bashkë me ju gjithë ditët gjer në mbarimin e jetës." Amin.

*Pastaj vazhdon Shërbesa e zakonitë e Mëngjezit gjer në Dërgimesoret, si në të Dielat e tjera të motit.*

## DERGIMESORET, T. II.

## TIS MATHITES SINELTHOMEN

Mblidhuni me Dishepujtë, në Mal të Galilesë, ku po na thotë Zoti Krisht, se e ka marrë forcën, kudo mi dhen' e mi qjellin; se atje pagëzimin, për gjithë kombet urdhëroj, n' emër t' Atit e Birit e Shpirtit Shenjt, dhe kështu të mbetemi të bashkuar, përherë pas premtimit tij, gjer në fundin e jetës.

Shën Janin Parërendësin, Apostujt' e Profetët, Dëshmorët Kryepriftërit, Ashkëtinjt' Oshënarët, edhe Hierodëshmorët, edhe Gratë besnike, dhe togjet e të Drejtëve, edhe Engjëjt' e qjellit me brohori, le t'i përhymojmë le t'u thërresim: Lavdinë tuaj epani, përpara Jesu Krishtit.

Gas pate me dishepujtë, o Mari Virgjëreshë, se e shikove Zotin Krisht, që u-ngjall pas tri ditësh, qëndroj në mezin e tyre, dhe atje pagëzimin, për gjithë kombet urdhëroj, n' emër t' Atit e Birit e Shpirtit Shenjt, të besojmë Ngjalljen e Shpëtimtarit, dhe të hymnojmë ty me mall, Virgjëreshë dhe Zonjë.

## LAVDERIMET

*Këndohen tetë, domethënë pesë të Tingëllit edhe tri të Shenjtorëve:*

## PAS IKOS TU EFRATHA

Zoti i lavdëroj, Shenjtorët dhe Dëshmorët, si Krishti u-munduan, dhe ndritnë me virtuta, si lule dhe si yj në qjell.

Atër dhe Apostuj, Profetë dhe Dëshmorë, Barinj dhe gra të Shenjta, Mësonjës dhe Shenjtorë, me këng' i lavdërojmë sot.

Zbrittë qjellin mi dhe, me vepra dhe virtuta, si Krishti hoqt' e vdiqtë, edhe me gjak fituat, kurorën e Shenjtorëve.

LAVDI, T. I. Kur në malin e Galilesë Apostujtë, të helmuar shkonin lart me vrap, u-çfaq Jetëdhënësi, dhe si iu-fal në nderim, edhe dëgjuan porrosinë, t'i pagëzojnë të gjithë, u-dërguan në botën e paganëve, lëçitës të Ngjalljes së triditë, dhe ngjitjes në Parajsën e Shenjtorëve, dhe me ta premtoj të mbetet gjer në mbarimin e jetëve, Jesuj Perëndi, Shpëtimtar i besnikëve.

TANI. E përmibekuar je, o Hyjlindëse Virgjëreshë. Të hymnojmë, se prej Birit që linde, Ferri u-robërua, Adami u-nduall prapë, mallkimi vdiq, Eva u-çlirua, vdekja u-dërmua, dhe ne muarmë jetë. Përandaj po hymnojmë dhe thërresim: I bekuar je, o Krisht Perëndi, që e pëlqeve kështu, lavdi më ty.

*Doksollogjia e Madhe, dhe Mesha e Shën Joan Gojartit. Në Hyrjen këndohen:*

## PERLESHORJA E TINGELLIT TERTHOR IV

Që lartazi zbrite o Zoti Krisht, dignove varrim të triditëshme, që të na mprosh të na çlirosh nga çdo pësim; ti që jetën edhe ngjalljen na dhuron, o Zot lavdi më ty.

## PERLESHORJA E SHENJTOREVE, T. IV.

Kisha jot' e stolisur me një stoli, të spërkatur me gjak të Dëshmorëve, që kanë vojtur në tërë botën, me ata të lutet o Krisht Perëndi: Fal-i popullit tënt mëshirat e pasura, dhuroji paqen perherë shtetit tënt, dhe shpirt-eve tona përdellimin e math.

*Hyrtoja e zakontë Dielore. Përlëshorja e Shenjtisë të Kishës. Pastaj:*

## SHKURTORJA, T.T. IV.

Posi kulloshtër dhe kurban, për Perëndinë krijetar, bota e tërë të blaton o Zot, ushtërit' e Dëshmorëve. Pra me lutjet e tyre, në paqe të thellë Kishën ruaj-e, me anën e Shën Marisë o Perëndi mëshirëplot.

*Pas Trishenjtisë këndohet Apostulli dhe Ungjilli (shiko Kremtoren, f. 152-4).*